



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me, neni 63, nenin 64, nenit 113 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 19 të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe nenin 41 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përmes votimit në procedurë qarkulluese më datën 21.03.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) për vitet 2026-2028

- I. Miratohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve për vitet 2026-2028.
- II. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 21.03.2025





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 dhe nenin 3 paragrafi 3.2 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi c dhe 37 paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3, nenin 5, paragrafi 5.1.3 dhe 5.1.9, nenin 6 dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, si dhe nenin 41 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përmes votimit në procedurë qarkulluese më datën 21.03.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Emërimin e Anëtares të Kuvendit Komunal

- I. **Znj.Donjetë Baliu**, emërohet anëtare e kuvendit komunal në Podujevë, nga subjekti politik "Lëvizja Vetëvendosje", duke e zëvendësuar anëtares të kuvendit komunal znj.Drita Pajaziti.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj.Donjetë Baliu dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 20.03.2025, Nr.07/7/752/2025, për zëvendësimin e anëtares të kuvendit komunal znj.Drita Pajaziti, e cili ka dhënë dorëheqje për arsye të zgjedhjes deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidatja e radhës në listën e rirenditur është znj.Donjetë Baliu. Kandidatja e radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, e gjinisë së njëjta me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021. Andaj, pas plotësimit të kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë, 21.03.2025

Kreshnik RADONIQI

Kryesues i KQZ